



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 448/ 2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Vlastimir Dimić dhe Ferit Osmani, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Ekrem Kryeziu në cilësinë e Komisionarit nga subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsi gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REUZOHET** si e pabazuara ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

## **A r s y e t i m**

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 12.12.2010, nga subjekti politik LVV, me te cilën pretendohet se më datë 12.12.2010, në ora 10:00, në Dobërçan, në Qendrën e Votimit (QV) nr. 0406/D, komisionari i PDK-së Ekrem Kryeziu, ka vulosur shumë fletëvotime para se votuesit të hynin në Vendvotim. Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur katër fotografi si dëshmi.

Në raportin e Policisë të datës 13.12.2010, për QV 0406/D/, e cila është në Dobërçan komuna e Gjilanit, theksohet se nuk ka pas ndonjë ankesë që ndërlidhet më këtë rast, në raport po ashtu theksohet se nga policia që ka qenë prezent dhe kanë monitoruar gjendjen e sigurisë në këtë pikë votimi nuk kanë pranuar ndonjë ankesë.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

**- ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara ngase nuk janë ofruar dëshmi të për të besuar se kanë ndodhur shkelja e tillë në QV 0406D. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 448/2010 më datën 14.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit  
Rafet Haxhaj**

